

Instituti Alb-Shkenca krijon hapësira diskutimi për problemet e Shëndetësisë mbarëshqiptare

Nga Dr. Altin Stafa

Drejtues i Seksionit të Shkencave Mjekësore-Instituti Alb-Shkenca
Bologna, Itali.

Në kuadrin e Takimit VI Ndërkombëtar dhe Mbarëkombëtar të organizuar nga Instituti Alb-Shkenca (IASH) në Prishtinë, nga 1 deri në 4 shtator, u organizua edhe një tryezë e rrumbullakët diskutimi mbi problemet e mjekësisë mbarëshqiptare.

Tryeza e rrumbullakët, organizuar në datën 1 shtator nga Seksioni i Shkencave Mjekësore të IASH pati si temë bosht: “Sistemi shëndetësor dhe ai arsimor mjekësor universitar dhe pas-universitar në hapësirën shqiptare ballkanike: diferencat, dimensionet e përbashkëta, mundësi konvergjimi të mëtejshme”.

Në këtë tryezë të rrumbullakët, e para e llojit të vet e organizuar nga një organizëm jo-qeveritar shqiptar, morën pjesë Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës Prof. Ferid Agani; Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Shqipërisë Prof. Petrit Vasili; Prof. Tritan Shehu, Kryetar i Komisionit parlamentar të Çështjeve Sociale, Punës dhe Shëndetësisë të Kuvendit të Shqipërisë dhe Prorektor i Universitetit “Zonja e Këshillit të Mirë” Tiranë; Prof. Alfred Priftanji, Dekan i Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Tiranës; Dr. Skënder Syla, Drejtor i Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë; Dr. Klodjan Allajbeu, Drejtor i Spitalit Amerikan në Tiranë dhe z. Valbon Krasniqi, i ngarkuari me punë në bashkinë e Prishtinës për politikën shëndetësore.

Eshtë për t’u theksuar fakti se aktiviteti i organizuar nga IASH në Kosovë përfaqësoi edhe takimin e parë jo-zyrtar të dy Ministrave të Shëndetësisë në këtë vend. Ky takim jo-zyrtar, u pasua të nesërmen e Tryezës së Rrumbullakët nga takimi i parë zyrtar i tyre në Kosovë.

Në prezantimet e tyre, ministrat Ferid Agani dhe Petrit Vasili, përveç paraqitjes së një pasqyre të plotë të gjendjeve të sistemeve shëndetësore në të dy vendet shqiptare të Ballkanit, shprehën vullnetin e qartë për të thelluar edhe më tej bashkëpunimin. Në veçanti, ministri Vasili, theksoi ndihmën e vazhdueshme që Shqipëria po i jep Kosovës për anëtarësimin e saj të plotë në OBSH.

Për sa i përket perspektivës së Sistemit Shëndetësor në Shqipëri ministri Vasili, vuri theksin në rëndësinë madhore që kanë reformat për shëndetësinë aktuale në Shqipëri, reforma që bazohen kryesisht në forcimin dhe rritjen e hapësirës së dimensionit privat.

Nga ana e tij, Ministri Agani përmendi si element me shumë rëndësi në strategjitë e ardhshme politikë-bërëse bashkëpunimin e ndërsjelltë të dy shteteve shqiptare dhe nënvizoi rëndësinë e dimensionit psiko-social të popullsisë së Kosovës në hartimin e politikave shëndetësore.

Në vijim, prof. Titan Shehu, bëri një prezantim të detajuar mbi raportin dinamik mes shëndetësisë dhe tregut. Argumenti u pa në një këndvështrim evolutiv, ku u cekën elementet e politikave shëndetësore të shkuara, u përshkrua gjendja aktuale dhe u propozuan elemente të perspektivës së

ardhshme. Në optikën e tij, prof. Shehu e vuri theksin në nevojën e decentralizimit të Shëndetësisë dhe në nevojën e vendosjes së një sistemi bazuar mbi indekset e kostos (*sistemi DRG – Diagnose Related Groups*).

Më tej, Prof. Alfred Priftanji, trajtoi argumentin “Specifika dhe nevojat e formimit mjekësor universitar dhe pas-universitar në Shqipëri“. Prof. Priftanji nënvizoi mungesat e dukshme të numrit të docentëve në Fakultetin e Mjekësisë së Tiranës (aktualisht raporti pedagog/student është 1/8 krahasuar me atë 1/5 të kërkuar nga standartet). Sipas Prof. Priftanjit, tjetër element për t’u korrigjuar është mungesa e mjekëve dhe infermierëve, mungesë e theksuar edhe në krahasim me shtete të tjera ballkanike. Në përfundim, ai theksoi se nevoja për reforma edhe brenda sistemit universitar është jetike; përpos të gjitha elementeve teknike organizative, këto reforma duhet të çojnë në ndryshimin e filozofisë së mësimdhënies në Fakultetin e Mjekësisë duke ndryshuar qendrën e gravitetit didaktik nga docenti tek studenti.

I ftuari i radhës, Dr. Skënder Syla, bëri një pasqyrë të plotë të mbështetjes së OBSH ndaj shëndetësisë kosovare, në të gjitha aspektet dhe nevojat e saj të shumta. Anëtarësimi i Kosovës si anëtare me të drejta të plotë në OBSH, mbetet element i një rëndësie parësore në realizimin e strategjive afatgjata shëndetësore.

Më tej, Dr. Klodjan Allajbeu bëri një prezantim të detajuar të organizimit, shërbimeve aktuale dhe potenciale të Spitalit Amerikan të Tiranës, si një shembull pozitiv konkret i prurjeve të dimensionit privat në shëndetësinë shqiptare.

Në mbyllje, Z. Valbon Krasniqi theksoi rëndësinë e përfshirjes së bashkive e komunave në strategjitë politike-bërëse, si hallka terminale e rrjetit kapilar të një sistemi shëndetësor.

Pas referimeve, të ftuarit iu përgjigjën pyetjeve të ndryshme të pjesëmarrësve.

Në bazë të kësaj përvoje të re e pozitive, Seksioni Shkencave Mjekësore i IASH arriti në përfundimin se temat e përzgjedhura për këte tryeze diskutimi ishin të volitshme dhe të një rëndësie të veçantë për aktualitetin e zhvillimeve shëndetësore dhe edukative në Kosovë dhe Shqipëri. Të ftuarit përfaqësonin specialistët më kompetentë aktualisht në këtë fushë. Në tema u gërshetuan aspektet e qeverisjes, financimit, shërbimeve si dhe kuadrit të sistemit shëndetësor, si parakushte të domosdoshme për funksionimin e mirefilltë të ketij sistemi. Apekti i sektorit privat në sistemin shëndetësor u përpunua qartë nga prezantuesit. Forma e zgjedhur nga organizatorët (prezantime individuale dhe diskutime pyetje-përgjigje) është për t’u konsideruar një formë organizimi dinamike dhe efikase, interesante për t’u aplikuar edhe në aktivitete që Instituti Alb-Shkenca e ndoshta edhe institucione të tjera do të organizojnë në të ardhmen.